



Save the Children



Sweden
Sverige



Microsoft

Drejt mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të fëmijëve

Politika dhe mjete për të promovuar të drejtat themelore, për sigurinë
dhe mbrojtjen e fëmijës në mjedisin shkollor

Këto materiale/prodhime financohen nga Qeveria e
Suedisë. Përgjegjësinë e përmbajtjes në tërësi e mban
autori. Qeveria e Suedisë, jo domosdo i ndan qëndrimet
dhe interpretimet e shprehura.

Dhjetor, 2019

Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megashi nga Maqedonia (PDAS Megashi) punon me “vizion i cili është përkushtuar për një botë më të drejtë për çdo fëmijë dhe e ndjek “moton se të gjitha idealet në botë janë më pak të rëndësishme në krahasim me lotët e një fëmije. “

Shfrytëzimi dhe zbatimi i këtyre politikave për mbrojtje të fëmijëve janë mënyra në të cilën PDAS Megashi vërteton dhe siguron se janë në pajtim me dokumentet, normat dhe standardet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijës, njëkohësisht duke i ndjekur rregulativat ligjore pozitive dhe dokumentet, konceptet normative-juridike, të cilat kanë të bëjnë me sistemin edukativ-arsimor në shtetin tonë.

Materiali është strukturuar në 4 elemente/kapituj, është harmonizuar me dokumente, instrumente dhe standarde ndërkombëtare për mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre, është testuar në disa shkolla fillore dhe është në pajtim me Ligjin për arsim fillor, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 161 nga 5.8. 2019 neni 5 dhe neni 66.

Në pjesën e parandalimit mund të jenë të dobishme veglat, instrumentet, procedurat, indikatorët e ofruara, tanimë të përgatitura të llojeve të dhunës, keqpërdorimit, neglizhimit, sepse në përpunimin e tyre janë përfshirë më shumë institucione relevante, në pajtim me dokumentet ndërkombëtare, ndërsa janë testuar në disa shkolla fillore.

Përmbajtjet e ofruara në broshurën, përveç parandalimit, mund të ndihmojnë shumë edhe në zhvillimin e dokumenteve konceptuale, akteve nënligjore, zhvillimin e programeve preventive sepse definojnë lloje të dhunës, keqpërdorimit, neglizhimit, japin drejtime si punohet në disiplinën pozitive në shkollat, disiplinën prindërore, bashkëpunimin me prindërit dhe ngjashëm.

Paraqitja - procedura për paraqitje dhe mbrojtje të nxënësit – viktimë të cilësdo prej formave të dhunës së keqpërdorimit dhe neglizhimit përcaktohen me akt nënligjor (protokoll) për të cilin është kompetent Byroja për zhvillim të arsimit, ky material është në fazë të përpunimit, ndërsa materiali i ofruar në broshurën mund të ndihmojë në finalizimin e tij. Në pjesën e paraqitjes, si dhe në pjesën e parandalimit dhe procedurës, ballafaqimi me dhunën - mund të japë drejtime dhe rezultate pozitive.

Neni 5. Në Ligjin për arsim fillor Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 161 nga 5. 8. 2019 thotë – Mbrojtja nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë në paragrafin 4 ceket “të punësuarit nga SHF janë të detyruar që të promovojnë barazi dhe drejtësi ndërmjet të gjithë nxënësve dhe t'i kundërshtojnë aktivisht të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës”.

Në masat dhe drejtimet preventive janë edhe programet preventive që ofrojnë drejtime për ndërtim të ekipeve, pastaj se si ekipi përgatit program, në programin ka lloje të definuara të dhunës pas keqpërdorimit dhe neglizhimit, lloje të ndryshme të aktiviteteve, punëtorive, teknikave, metodave, si të përforcohet bashkëpunimi me prindërit dhe disiplina, klima pozitive dhe bashkëpunimi në shkollat.

Janë sqaruar nocionet/dukuritë/procedurat për disiplinë pozitive dhe ndjenjë pozitive prindërore, për disiplinën pozitive në shkollën, nocionin, karakteristikat, stilet dhe zhvillimin

e personalitetit të fëmijës, komunikimin prind-fëmijë (aspekt i rëndësishëm i disiplinës pozitive) shkathtësinë unë - të folurit, si gjuhë e pranimit.

Protokolli për veprim – shembuj të fëmijëve të cilët janë keqpërdorur dhe neglizhuar. Gjithashtu në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, janë përshkruar udhëzime konkrete, drejtime, rregulla (evakuacion), bashkëpunim me institucionet, ministritë tjera relevante.

Ky material/broshurë definon disa politika, procedura/vegla që janë vendosur në praktikë/shkollë dhe që mund të ndihmojnë në punën e mësuesve, shërbimeve profesionale dhe organeve dhe trupave ose subjekteve tjera të përfshira në procesin edukativ-arsimor, për mbrojtje dhe promovim të të drejtave të fëmijëve, për ndërtim të kulturës për shkollë të sigurt si dhe për ndërtimin e arsimit paqësor në sistemin arsimor-edukativ.

Në pajtim me të lartpërmendurën ky material/broshurë mund të gjejë zbatim pozitiv në shkollat, si dhe në institucionet që punojnë në promovimin, realizimin e të drejtave themelore të sigurisë, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Përpunoi, Sofka Koceva
Këshilltare në Byronë për zhvillim të arsimit
25. nëntor 2019

PËRMBAJTJA

Parathënie ...

1. Hyrje dhe Protokoll veprimi në rast të dhunës ...

Hyrje ...

Protokolli për veprim në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi ...

Indikatorët e keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve ...

Indikatorët e keqpërdorimit fizik të fëmijëve...

Indikatorë të abuzimit seksual të fëmijëve ...

Indikatorë të keqpërdorimit emocional të fëmijëve ...

Indikatorët e neglizhimit të fëmijës ...

Veprimi gjatë keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve

Njohja e keqpërdorimit dhe neglizhimit

Zbulimi

Konsultime dhe vlerësim i keqpërdorimit dhe rrezikut nga keqpërdorimi

Dokumentimi i gjendjes së fëmijës dhe rrethanave në lidhje me keqpërdorimin/neglizhimin

Dyshimi për keqpërdorim dhe neglizhim

Paraqitja e dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në QPS

Kur duhet të pritët me paraqitjen

Paraqitja e dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në Policinë ose në Prokurorinë publike

Vlerësimi i gjendjes, nevojat dhe rreziku nga keqpërdorimi/neglizhimi i fëmijës dhe familjes pas paraqitjes së rastit në QPS

Keqpërdorimi fizik

Abuzimi seksual

Keqpërdorimi emocional (psikologjik) dhe neglizhimi

Neglizhimi

Cilët fëmijë janë në rrezik të keqpërdorimit dhe neglizhimit....

Korniza për vlerësimin e rrezikut për keqpërdorimin dhe neglizhimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre

2. Propozim-plani aksional për zvogëlimin e dhunës

3. Plan për reagim në gjendje të jashtëzakonshme

Parathënie

Ideja se dhuna ndaj fëmijëve doemos duhet të parandalohet është relativisht e re: dokumentet e para lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna datojnë nga fundi i shekullit 19, ndërsa bile edhe në shekullin 20 fillon përhapja e qëndrimit se dhuna ndaj fëmijëve doemos duhet të parandalohet, përkatësisht të ndëshkohet dhe të trajtohet në mënyrë adekuate.

Përvojat e deritanishme tregojnë se në Maqedoni problemi me sjelljen e dhunshme injorohet ose shpesh kërkohet zgjidhje në angazhimin e agjencive profesionale për sigurim të cilat e “ruajnë” shkollën. Numri i incidenteve dhe rrahjeve ndoshta zvogëlohet në këtë mënyrë, por megjithatë kjo është larg zgjidhjes së problemit të llojet tjera të sjelljes së dhunshme. Në trajtimin e problemit është me rëndësi të përfshihen të gjithë anëtarët e komunitetit, e veçanërisht të rinjtë, në zhvillimin dhe vendosjen e mekanizmave për zgjidhjen e problemit me dhunën, përmes zvogëlimit të vazhdueshëm të dimensioneve të tij, përmes zbulimit të shkaqeve dhe ballafaqimit më të mirë me pasojat. Njohuritë e fituara nga hulumtimi i gjendjeve dhe lidhja e tyre në aksionet që janë menduar dhe realizuar nga fëmijët bashkë me të rriturit, mund të përdoren për zhvillimin e politikës dhe ndërhyrjeve efektive për reduktimin e dhunës në shkollat.

Njëra prej arsyeve që fëmijët janë të rrethuar me dhunë, është ajo që ne, të rriturit, reagojmë ndaj tyre vetëm kur ndodhin lëndime dhe dhunë fizike. Fëmijëve dhe të rriturve të dhunshëm u kushtohet vëmendje më të madhe dhe janë në ballinat në mediat, ndërsa fëmija i cili ka fituar çmim në matematikë fiton tre rreshta në faqen e fundit në mediumin. Hulumtimet tregojnë se prindërit kalojnë dhjetë minuta në ditë me fëmijët e tyre. Ato në ato 10 minuta nuk mund të ballafaqohen me asgjë, e mos të flasim për bisedë me fëmijët se çfarë do të thotë dhunë. Sajberbulingu gjithashtu është në rritje, veçanërisht sepse fëmijët që nuk kanë vëmendje të mjaftueshme në shtëpi, mund në mënyrë anonime nga dhoma e vet të ofendojnë, përqeshin fëmijë dhe të tregohen të rëndësishëm.

Andaj, kjo broshurë do të kontribuojë për parandalim të dhunës edhe te fëmijës, edhe te prindërit, por edhe te kuadri mësimor përmes qasjes sistematike në punë me këto tre grupe.

Në mënyrë plotësuese, njohja e protokollit, principet e disiplinës pozitive dhe ndjenja pozitive prindërore, si dhe planet për reagimin në gjendje urgjente, por edhe propozim-plan veprimet, duhet të paraqesin pikënisje për zhvillimin e vetëdijes dhe hap të parë për zvogëlimin dhunës.

Informatat të cilat janë plasuar në këtë broshurë janë pjesë e projektit të Megashi me Save the Children Kocovo.

Prof. dr. Sofija Georgievska

1. Hyrje dhe Protokoll veprimi në rast të dhunës

Hyrje

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të fëmijërisë së lumtur dhe të sigurt, të cilën ua garanton Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, që paraqet dokument më të pranuar universal në historinë e të drejtave të njeriut. Konventa ofron kornizë dhe drejtim për mbrojtje dhe zhvillim të plotë të potencialeve dhe kapaciteteve të çdo fëmijë, ndërsa shteti, si nënshkrues i saj, është përgjegjëse në masën më të madhe të sigurojë kushte të domosdoshme për zhvillimin e fëmijëve dhe për avancimin e të drejtave të tyre, duke i vënë fëmijët në fokusin e sistemit për mbrojtje sociale.

Dhuna ndaj fëmijëve është një prej problemeve më serioze që e rrezikojnë zhvillimin, shëndetin dhe mirëqenien e tyre, të drejtat themelore, dinjitetin dhe mund ta vënë në pikëpyetje jetën e fëmijës. Kjo ndodh gjithkund, në shtëpi, shkollë ose në institucionet për kujdes të fëmijëve, në rrugë. Një pjesë e madhe e dhunës ndaj fëmijëve mbetet e fshehur. Fëmijët kanë frikë ta paraqesin për shkak të frikës dhe lidhshmërisë me dhunuesin ose sepse dhunën nuk e konsiderojnë si diçka të gabuar ose të pazakontë, por si dënim të arsyeshëm dhe të domosdoshëm për procedurat e tyre. Fëmijët viktimë të dhunës mund të ndjehen fajtorë dhe të besojnë se e kanë merituar. Gjatë historisë, por edhe sot në kultura të ndryshme ndëshkimi fizik ka qenë dhe ende është një prej mënyrave të disiplinimit dhe edukimit të fëmijëve si në familje ashtu edhe në shkollë.

Fatkeqësisht, fëmijët në shkollë shpesh lihen pas dore dhe të ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të dënimeve dhe keqpërdorimeve trupore, psikike dhe seksuale, që shkaktojnë pasoja afatgjate në zhvillimin e tyre dhe shkelje të të drejtave të tyre. Në dekadën e fundit, dhuna ndaj fëmijëve konsiderohet si një prej dukurive më të dëmshme dhe më të rrezikshme në fëmijërinë e shumë fëmijëve në mbarë botën. Për frekuencën e kësaj dukurie sugjerojnë të gjitha konstatimet dhe rekomandimet nga institucionet relevante. Duke pasur parasysh izolimin e këtij problemi, nuk dihet dhe nuk flitet mjaftueshëm për shkallën e shpeshtimit të dhunës, për llojet e saj dhe shkaqet për ndodhjen e saj në shkollat e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Protokolli për veprim në procesin e parandalimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi

Mbrojtja e fëmijëve është proces i ndërlikuar, por njëkohësisht edhe i vetëm, me ç'rast bashkon më shumë ministri në veprimin e përbashkët. Si një prej përcaktimeve strategjike të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, është formuar një grup i veçantë pune për përgatitjen e Protokollit të përgjithshëm për parandalim dhe mbrojtje të fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi, i përbërë nga përfaqësues të ministrive relevante (mbrojtja sociale, shëndetësia, arsimi, gjyqësia, policia), shoqata joqeveritare, Avokati i popullit dhe organizata ndërkombëtare - OSHB dhe UNICEF.

Të gjitha format e dhunës, keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve, të cilat e rrezikojnë ose e cenojnë integritetin fizik, psikik dhe moral të personalitetit të fëmijës, paraqesin shkelje të të drejtave themelore të fëmijës të përfshirë në Konventën e Kombeve

të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e kjo paraqet të drejtën e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit.

Me marrëveshjet ndërkombëtare Republika e Maqedonisë obligohet t'i ndërmarrë masat për parandalim dhe të sigurojë mbrojtje të fëmijës nga të gjitha format e dhunës në familjen, në institucionet dhe në komunitetin më të gjerë shoqëror.

Qëllimi kryesor i Protokollit të përgjithshëm është vendosja e veprimit efikas dhe të koordinuar ndërmjet resorëve kompetentë dhe pjesëmarrësve për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi, në të cilin janë përfshirë llojet, mënyra dhe përmbajtja e bashkëpunimit dhe i cili do të mundësojë aplikim të intervenimeve përkatëse, zhvillimore dhe specifike, rimëkëmbje dhe do të sigurojë kushte për zhvillim të mëtutjeshëm të fëmijës.

Gjithashtu, Protokollin i përgjithshëm duhet të kontribuojë edhe për zhvillimin dhe përhapjen e rrjetit të ekipeve profesionale, multidisiplinore për zbulimin e fëmijëve viktimë të keqpërdorimit dhe neglizhimit të institucioneve në nivel lokal, e pastaj aplikim të modelit të bashkuar të punës së këtyre ekipeve në komunitetet lokale në gjithë vendin.

Indikatorët e keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve

Keqpërdorimi dhe neglizhimi i fëmijëve mund të kenë forma të ndryshme. “Keqpërdorimi” do të thotë lëndim aktiv të fëmijës ose privimi i fëmijës nga emocionet dhe pranimi i “neglizhimit” do të thotë moskujdesi ndaj fëmijës.

Indikacioni i parë se fëmijës është ndoshta i keqpërdorur dhe ka nevojë për mbrojtje mund të jetë vëzhgimi i raportit ndërmjet prindërit/kujdestarit dhe fëmijës.

Në tekstin e mëtutjeshëm do t'i prezantojmë indikatorët themelorë për keqpërdorim dhe neglizhim të fëmijëve. Megjithatë ekzistojnë 4 kategori themelore të keqpërdorimit dhe neglizhimit, përfshirë edhe eksploatimin e fëmijëve, çdo rast i veçantë mund të jetë kombinim i secilit prej tyre.

Indikatorët e keqpërdorimit fizik të fëmijëve

Shenjat e vëzhguara te fëmija

- Blana të paqarta ose të pashpjegueshme në pjesët e mbuluara të trupit: në barkun, në shpinë, në anën e prapme të kofshës dhe kërcit;
- Shenja;
- Të skuqura dhe të mavijosura me ngjyra të ndryshme, në formë të sendit (litar, brez, shputë, shkop);
- Flokë të shkullura, dhëmbë që mungojnë;
- Plaga të shkaktuara nga kafshimi;
- Të djegur shkaku i të cilave nuk mund të sqarohet:
 - nga cigare;
 - nga derdhja e valës: në lloj të dorezës, në lloj të çorapit;
 - nga rryma;
- Fraktura, ndrydhje ose lëndime në kokë që nuk mund të sqarohen;
- Helmim me mjete helmuese, korrozive, substanca psikoaktive;

Однесувања набљудувани кај детето:

Детето може да има:

- страв од физички контакт со возрасни;
- страв од родител или друг член на семејството;
- исплашен од плач на други деца;
- лесно се штрека на дразби;
- покажува екстреми во однесувањето – агресија или повлекување;
- прекумерно е анксиозно;
- лесно приоѓа на возрасни и непознати;
- не дозволува да биде прегледано;
- не поднесува физички контакт или допир;
- бега од дома;
- не може да воспостави добар однос со врстници;
- има ниска самопочит;

Sjellje të vëzhguara te i rrituri

I rrituri mund të jetë:

- i hidhëruar, i padurueshëm, shpesh të humbë kontroll mbi sjelljen;
- duket i pasigurt në aspekt të gjendjes së fëmijës;
- e konsideron fëmijën të keq ose shkak për problemet e tij jetësore;
- bën rezistencë ndaj bisedës për gjendjen e fëmijës ose për familjen;
- pyetjet i shikon me dyshim;
- shfrytëzon mënyra të disiplinimit joadekuate për moshën e fëmijës, gjendjen ose situatën;
- jep sqarime të palogjikshme, kontradiktore, jobindëse, ose kurrfarë sqarime për lëndimet;
- nuk tregon mirëkuptim të mjaftueshëm për zhvillimin normal të fëmijës, ka pritje nga fëmija joadekuate për moshën;

Indikatorë të abuzimit seksual të fëmijëve

Shenjat e vëzhguara te fëmija

Dëshmitë fizikë për abuzim seksual janë të rralla. Shpeshherë kur janë në pyetje fëmijët e vegjël, nuk bëhet fjalë për marrëdhënie seksuale, por për prekje seksuale të cilat nuk është patjetër ose rrallë lënë gjurma. Atje ku ka shenja fizike, ato mund të jenë:

- veshje të grisura, të përgjakura ose të fëlliqura;
- dhembje ose kruajtje në pjesën e organeve gjenitale ose në fyt, vështirësi gjatë kryerjes së nevojës së madhe ose gjatë të gjëlltiturit;
- blana, gjakderdhje ose ënjtje në organin gjenital, pjesën orale ose anale;
- lëngu vaginal;
- dhembje barku, dhembje koke, ose ankesa tjera psikosomatike;

Sjellje të vëzhguara te fëmija:

- përdor fjalë me shprehje seksuale ose vizatime me përmbajtje seksuale;
- fantazon shumë;
- regon frikë në hapësirë të mbyllur;
- bën rezistencë gjatë zhveshjes ose ndërrimit të pelenave;
- masturbon shumë;
- regon sjellje joshëse;
- regon të kuptuarit e hershëm ose të papërshtatshëm të sjelljes seksuale ;
- regon sjellje seksuale të papërshtatshme, të pazakontë ose agresive me moshatarët ose lodrat;
- ka preokupime seksuale ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes;
- ka pushuar së kontrolluari nevojën e vogël dhe të madhe;
- ka çrregullime në ushqimin;
- ka frikë ose sjellje të detyrueshme (vazhdimisht pastrim, larje, ndërrim rrobash)
- ka probleme me koncentrimin dhe mësimin ose rënie të suksesit në shkollë;
- regon sjellje të papërshtatshme: sjellje vetëshkatërruese (vetëlëndim, përdorim të alkoolit, drogës, ikje nga shtëpia, tentim për vetëvrasje);
- ka probleme me gjumin, siç janë ankthet, frikë të mos e zë gjumi dhe frikë të mos flejë gjatë;

Sjellje të vëzhguara te të rriturit:

- i rrituri mund të dominojë, por emocionalisht të jetë i dobët;
- regon vështirësi martesore ose në raportet me të rriturit;
- regon izolim social, vetmi;
- mbështetet te fëmija edhe emocionalisht edhe fizikisht;
- e mban fëmijën dhe e prek në mënyrë të papërshtatshme;
- i akuzon të tjerët për problemet jetësore, përfshirë edhe fëmijën për sjellje të seksualizuar;

Indikatorë të keqpërdorimit emocional të fëmijëve

Sjellje të vëzhguara te fëmija

Pamja e fëmijës mund të jetë e rregullt dhe të mos ketë shenja që tregojnë për peshën e problemit. Fëmija mund të duket i pastër, i kujdesur dhe i ushqyer mirë. Shprehja e fytyrës mund të tregojë pikëllim, mungesë disponimi, turpërim ose hidhërim i përmbajtur.

Sjellje të vëzhguara te fëmija:

- është i dëgjueshëm, pasiv, i turpshëm;
- regon episode të agresivitetit, tërbimit dhe hidhërimit;

- ka frikë nga mosesukseset, ka vështirësi në koncentrim, mësim dhe tërhiqet lehtë;
- ka sjellje negative ndaj vetes;
- kërkon falje vazhdimisht;

-qan pa provokim;
-vazhdimisht kërkon vëmendje nga i rrituri;

Sjellje të vëzhguara te i rrituri:

-e akuzon dhe e poshtëron fëmijën publikisht dhe në shtëpi;
-nuk e qetëson fëmijën kur është i frikësuar dhe i shqetësuar;

-fëmijët tjerë në familjen i trajton më ndryshe dhe më mirë, duke treguar se i pranon më shumë dhe më pak kritikë;
-fëmijën e përshkruan në mënyrë të degraduar: budalla, i keq, problematik dhe parasheh mosesukses tek ai;
-e konsideron fëmijën përgjegjës për problemet dhe dëshpërimet prindërore;
-e barazon fëmijën me të tjerët në familjen të cilat nuk i do;

Indikatorët e neglizhimit të fëmijës

Shenjat dhe sjelljet e vëzhguara te fëmija

-peshë më të ulët, dehidrim, plogështi, bark të ënjtur;
-tregon përmirësim në ngecjen e zhvillimit si përgjigje e stimulit dhe kujdesit të mirë;
-tregon shenja të dëmtimit: skuqe në pjesën gjenitale-anale, diarre, vjellje, anemi, probleme me frymëmarrjen;
-është vazhdimisht i ndotur, ose i veshur në mënyrë të papërshtatshme për rrethanat kohore, me rrobe të grisura;
-shpesh është i etur dhe i uritur;
-shpesh është i lodhur dhe i plogësht;
-kërkon kontakt dhe vëmendje fizike;
-e merr rolin e të rriturit ose prindit;
-nuk ka mbrojtje mjekësore dhe stomatologjike adekuate;

Sjellje të vëzhguara te i rrituri:

-jeton jetë kaotike në shtëpi me pak kujdes për nevojat personale;
-nuk e mbikëqyr fëmijën në periudha më të gjata kohore, as kur është i ekspozuar në veprime të rrezikshme potenciale;
-e lë fëmijën të kujdesen persona joadekuate;

-i jep fëmijës ushqim joadekuate, pije, barna;
-e dërgon fëmijën vazhdimisht herët në çerdhe/shkollë dhe e merr vonë;
-mbetet i/e painteresuar për përparimin e fëmijës, i paarrtshëm në telefon, dhe nuk u përgjigjet thirrjeve për të biseduar në lidhje me fëmijën;
-e eksploaton fëmijën ose e ekspozon në punë më të madhe;
-tregon apati dhe indiferencë;

Veprimi gjatë keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve

Mbrojtja e fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi është proces gjithëpërfshirës në të cilin marrin pjesë institucionet dhe ekspertët nga resorë të ndryshëm – mbrojtja sociale, policia, shëndetësia, arsimi, jurisprudenca, organizatat civile, Avokati i popullit dhe pjesëmarrësit tjerë. Të gjithë këto faktorë marrin pjesë njëkohësisht në atë proces ose ndërlidhen në veprimtarisë e tyre, çdokush duke vepruar në kuadër të kompetencave. Por, bashkëpunimi ndërmjet tyre është kryesore që të sigurohet aktiviteti i tyre i sinkronizuar dhe të definohen mirë rolet për 1. të parandaluar keqpërdorimin dhe neglizhimin, të hulumtohet rasti dhe të sigurohen dëshmi; 2. të ndërmerren masa për mbrojtje sociale dhe kujdes ndaj fëmijës.

Veprimi gjatë keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve nënkupton:

1. **Njohjen e keqpërdorimit dhe neglizhimit** të fëmijëve nga ana e ekspertëve, përmes zbulimit ose njohjes së drejtpërdrejtë të indikatorëve për KNF; 2. **Dyshimin për keqpërdorim dhe neglizhim**; 3. **Paraqitjen e keqpërdorimit dhe neglizhimit**, si dhe dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në Qendrën për punë sociale, Policinë ose Prokurorinë Publike.

Koordinimin e gjithë procesit duhet ta bëjë **Qendra kompetente për punë sociale**, si shërbim kryesor për mbrojtjen e fëmijëve dhe si organ i sigurimit të kujdestarisë.

Njohja e keqpërdorimit dhe neglizhimit

Zbulimi

Zbulimi është hapi i parë për mbrojtjen e fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi. Kjo është pjesa më e ndjeshme nga gjithë procesi dhe nga ai varet rrjedha dhe rezultati i mëtutjeshëm i fëmijës. Zbulimin më shpesh e kryejnë personat të cilët kujdesen në mënyrë profesionale, veçanërisht ekspertët në arsimin, mbrojtjen shëndetësore dhe në mjediset tjera në të cilat qëndrojnë fëmijët (edukatorët, mësuesit, psikologët, pedagogët, mjekët, infermieret, punëtorët socialë etj).

Keqpërdorimi dhe neglizhimi zbulohen më shpesh në dy mënyrat në vijim:

a) **Me njoftim/besim të drejtpërdrejtë nga ana e fëmijës** për rastin/rastet e keqpërdorimit dhe neglizhimit të personit të afërt, ose ekspertit i cili parashtron drejtpërdrejt pyetje lidhur me keqpërdorimin dhe neglizhimin ose tërthorazi, nga ana e personave tjerë që kanë njohuri ose dyshime se fëmija është keqpërdorur (prindër, anëtarë të afërt të familjes, fqinjë, mësues, pedagogë, psikologë, moshatarë).

Edukatorët në institucionet parashkollore, mësuesit, psikologët dhe pedagogët e shkollës, punëtorët socialë, punëtorët shëndetësorë, mund të jenë **“persona të besimit”** të cilëve fëmija u ka treguar frikët, sekretet ose rrëfimet në lidhje me keqpërdorimin. Personi i zgjedhur është kryesor në fazën e zbulimit dhe prandaj është shumë e rëndësishme që të jetë sensitiv për sinjalet dhe nevojat e fëmijës, të dijë të ofrojë mbështetje, siguri dhe inkurajim të vazhdueshëm, ndërsa

njëkohësisht të angazhohet aktivisht në ngritje të procesit për mbrojtje të fëmijës, përkatësisht në paraqitjen e dyshimit të organeve kompetente, (veçanërisht në Qendrën për punë sociale, por edhe në organet tjera, si: policia, prokuroria publike, avokati i popullit).

Nëse fëmija ju drejtohet si person i besimit në lidhje me keqpërdorimin ose neglizhimin e përjetuar atëherë.... :

- Gjeni vend të qetë që të mund të dëgjoni;
- Dëgjoni në mënyrë të qetë dhe vlerësuese;
- Dëgjoni fëmijën, në vend që ta pyetni drejtpërdrejt;
- Fëmija nuk guxon të detyrohet të japë informata, të merret në pyetje ose t'i jepen informata të rrejshme për besim të plotë;
- Bindni fëmijë se ajo që ka ndodhur nuk ka qenë faji i tij;
- Asnjëherë mos e ndërpritni fëmijën derisa i përkujton ngjarjet e rëndësishme;
- Pranoni ndjenjat e fëmijës;
- Tregoni se do të mundoheni t'i ndihmoni;
- Shkruani çfarë keni dëgjuar dhe çfarë keni parë;
 - a) Sa është e mundshme më saktë shënوني fjalët e fëmijës;
 - b) shfrytëzoni fjalët që i përshkruajnë gjërat që ua thotë fëmija;

Vërejtjet dhe informatat ruani në mënyrë të besueshme dhe të sigurt. Personi profesional duhet t'i sqarojë fëmijës për obligimin për t'i informuar shërbimet tjera.

Gjithashtu, me pyetje sistematike dhe rutinore nga ana e ekspertëve, punëtorët shëndetësorë, pedagogët dhe psikologët, për ekzistimin eventual të dhunës ndaj fëmijëve mund të merren të dhëna pohuese. Në atë rast pyetja e mëtutjeshme duhet të realizohet në pajtim me principet e mbrojtjes së fëmijës nga ritraumatizimi dhe njëkohësisht duke marrë të dhëna për atë që e përjeton fëmija.

b) Njohja e shenjave fizike të lëndimit të fëmijës, ose njohja e shenjave psikologjike dhe shenjave të fëmijës që tregojnë keqpërdorim dhe neglizhim të mundshëm të fëmijës.

Në bazë të ekzistimi të shenjave fizike të lëndimit të fëmijës, ose ekzistimit të shenjave psikologjike dhe shenjave në sjelljen e fëmijës, ekspertët siç janë mësuesit, pedagogët, psikologët, punëtorët shëndetësorë etj, duhet të bëjnë pyetje më sistematike për shkakun e lëndimeve dhe manifestimeve në sjelljen që tregojnë keqpërdorim dhe neglizhim të mundshëm.

Gjatë njohjes nëse bëhet fjalë për keqpërdorim dhe neglizhim, duhet që ekspertët t'i analizojnë të gjitha faktet ekzistuese dhe situatën e përgjithshme të fëmijës dhe familjes së

fëmijës, duke pasur parasysh atë që nuk ekzistojnë shenja dhe simptoma specifike në bazë të të cilave me siguri të plotë mund të pohojmë se bëhet fjalë për keqpërdorim/neglizhim të fëmijës (shihni në kutitë përkatëse me shenja për keqpërdorim fizik, abuzim seksual, keqpërdorim emocional dhe neglizhim të fëmijës).

Konsultime dhe vlerësim i keqpërdorimit dhe rrezikut nga keqpërdorimi

Pas zbulimit ose paraqitjes së dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim, eksperti duhet të bëjë një ose më shumë konsultime:

- **Konsultim brenda në vetë shërbimin** me kolegët e tij që janë të informuar për problemin, por edhe me eprorët e tij. Ky konsultim nuk guxon ta ngadalësojë ose pengojë përkujdesjen urgjente ndaj lëndimeve dhe simptomave të fëmijës ose ndërmarrjen e masave për mbrojtje urgjente, nëse procedura e tillë është e nevojshme.
- **Konsultimi me prindin/kujdestarin** e fëmijës për keqpërdorimin, përveç në situatat kur konsultimi i tillë mund ta rrezikojë drejtpërdrejtë sigurinë e fëmijës.
- **Konsultimet me shërbimet tjera**, për të cilat supozohet se kanë njohuri për fëmijën dhe familjen, mund të bëhen në rast të nevojës (institucione arsimore, shëndetësore, Qendra për punë sociale, shërbimet SOS, etj). Qëllimi i këtyre konsultimeve është mbledhja e të dhënave plotësuese për fëmijën dhe familjen, të vlerësohet bashkërisht rreziku nga keqpërdorimi dhe neglizhimi i fëmijës dhe të arrihet marrëveshje për hapat e më tutjeshme që do të ndërmerren. Por nëse kushtet nuk lejojnë konsultime të llojit të tillë është e domosdoshme paraqitja e rastit në Qendrën kompetente për punë sociale.

Dokumentimi i gjendjes së fëmijës dhe rrethanave në lidhje me keqpërdorimin/neglizhimin

Zbulimi i keqpërdorimit/neglizhimit në cilindo sektor imponon nevojë për dokumentim të të dhënave lidhur me fëmijën, llojin e keqpërdorimit dhe autorin e keqpërdorimit. Duhet të shënohet identiteti i fëmijës (emri, mbiemri, numri i amzës, gjinia, mosha), shoqërimi nga ana e personave tjerë, autori i keqpërdorimit, rrethanat në të cilat ka ndodhur keqpërdorimi, gjendja e fëmijës, përshkrimi i lëndimeve eventuale të fëmijës dhe sjellja e tij, deklaratat e fëmijës lidhur me ngjarjen, deklaratat e shoqëruesve. Nëse ka mundësi duhet të bëhen fotografi të lëndimeve, vendit, të cilat mund të shfrytëzohen në procedurën e dëshmisë.

Dyshimi për keqpërdorim dhe neglizhim

Në rast të dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim ekzistues të fëmijëve, pa pasur informatë të qartë për atë, ekspertët që vijnë në kontakt me fëmijën dhe me familjen e tij duhet ta paraqesin rastin në Qendrën për punë sociale ose në Policinë, përkatësisht në Prokurorinë publike.

Paraqitja e dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në QPS

Paraqitja e rastit në Qendrën për punë sociale vijon pas bisedës së bërë me fëmijën (intervistë me fëmijën) dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme nga familja. Nëse ekziston dyshim për keqpërdorim në kuadër të familjes, atëherë eksperti e njofton prindin që nuk ka keqpërdorur se do ta paraqesë rastin në QPS, nëse konsideron se nuk do ta rrisë rrezikun për keqpërdorim të më tutjeshëm të fëmijës, përkatësisht lëndim të fëmijës.

Eksperti ose qytetari i cili paraqet dyshim për keqpërdorim dhe neglizhim të fëmijës në QPS duhet të plotësojë fletëparaqitje në të cilën do t'i shënojë të dhënat për fëmijën dhe familjen të cilat i njeh dhe do t'i arsyetojë konstatimet dhe shkaqet për të cilat e paraqet rastin.

Kur duhet të pritët me paraqitjen

Në disa raste duhet të pritët me paraqitjen, gjatë ekzistimit të dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim të fëmijës. Nëse institucioni në të cilin paraqitet dyshim për keqpërdorim ka ekip të organizuar dhe të edukuar për mbrojtje të fëmijëve nga keqpërdorimi dhe neglizhimi i cili pasi i ka shqyrtuar me ekipin gjendjet dhe ka konkluduar se janë përmbushur gjendjet në vijim:

- Rreziku nga keqpërdorimi dhe neglizhimi i fëmijës është i ulët;
- Familja e fëmijës ka kapacitet për të bashkëpunuar dhe është e përgatitur që të ndryshohet në drejtim të mbrojtjes më të mirë të fëmijës;
- Institucioni ka kapacitet që të merret me problemet e fëmijës dhe familjes;
- Vendimin për prolongim të paraqitjes së rastit duhet ta miratojë ekipi i institucionit;

Paraqitja e dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në Policinë ose në Prokurorinë publike

Paraqitja e dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim në Policinë ose në Prokurorinë publike bëhet nëse bëhet fjalë për veprime të cilat e rrezikojnë jetën ose shëndetin e fëmijës dhe të cilat paraqesin vepra penale që përndiqen me detyrë zyrtare. Këtu bëjnë pjesë **lëndimet e rënda trupore të fëmijës, rreziku për jetën e fëmijës dhe abuzimi seksual i fëmijës**. Rastet e tilla paraqiten nga ana e ekspertëve, pas qytetarëve ose institucioneve që kanë njohuri për to, në organet kompetente të MPB-së ose në Prokurorinë publike.

Gjithashtu, duhet të kihet kujdes që të sigurohen ose ruhen dëshmitë, nëse ekzistojnë, për shkak të procedurës së mëtutjeshme forenzike, përkatësisht çdo agjenci e involvuar të ndihmojë në sigurimin e dëshmive.

Të gjithë ekspertët pas paraqitjes së dyshimit për keqpërdorim dhe neglizhim duhet:

- T'u ndihmojnë aktivisht shërbimeve kompetente (QPS-së, policisë, Prokurorisë publike) në mbrojtjen e mëtutjeshme të fëmijës;
- T'i përgjigjen thirrjes për të marrë pjesë në mbledhje për shqyrtim të situatës së fëmijës dhe familjes;
- Të marrin pjesë në miratimin e vendimeve për masat e mbrojtjes dhe shërbimet që do t'i ofrohen fëmijës dhe familjes;
- Ta mbajnë kontaktin me fëmijën dhe familjen duke pasur rol të rëndësishëm në procesin e rimëkëmbjes së fëmijës dhe ndërprerjes së ciklit të dhunës.

Policia dhe prokuroria publike janë të detyruar që ta mbrojnë identitetin e ekspertit i cili e paraqet rastin ose duhet të sigurojë këshill juridik për ekspertët e përfshirë.

Vlerësimi i gjendjes, nevojat dhe rreziku nga keqpërdorimi/neglizhimi i fëmijës dhe familjes pas paraqitjes së rastit në QPS

Qendra për punë sociale është institucion kryesor i cili i pranon paraqitjes për keqpërdorim dhe neglizhim të fëmijëve nga çdo burim i mundshëm (qytetar, ekspert, institucion, OJQ).

Pas arritjes së paraqitjes për KNF në QPS, është e domosdoshme që ajo të shqyrtohet dhe të vlerësohet nëse janë përmbushur kriteret për hapje të rastit të KNF në qendrën nga ana e punëtorit social. Për atë qëllim fillimisht bëhet vlerësimi primar i cili ka për qëllim ta konstatojë gjendjen e fëmijës, rrezikun nga keqpërdorimi, dhe nevojat e fëmijës dhe familjes.

Hapi 1: Vlerësimi fillestar/Vlerësimi i trefishtë

Eksperti nga QPS i cili e pranon paraqitjen ka për detyrë t'i shqyrtojë informatat e dorëzuara, të kontrollojë nëse ekzistojnë paraqitjet paraprake për fëmijën dhe familjen në QPS dhe nëse ekziston edhe dokumentacioni mjekësor shoqërues. Pastaj është e domosdoshme që të vendoset kontakt me parashtruesin e paraqitjes (prindi, qytetari, eksperti, institucioni) dhe në bazë të të gjitha të dhënave të nxjerrë konkluzion për veprimet e mëtutjeshme që do t'i ndërmerren: moshapja e rastit në QPS, b) hapja e rastit në QPS, c) Ndërhyrje urgjente në lidhje me fëmijën.

a) Moshapja e rastit në QPS

Ky rezultat është i mundur nëse punëtori profesional (punëtori social, psikologu, pedagogu) në QPS konkludon se kriteret për gjendjet dhe rrethanat në të cilat hapet rasti në QPS nuk janë përmbushur, dhe për këtë arsye nuk janë të domosdoshme masat për mbrojtjen e fëmijës dhe planifikimin e ndërhyrjeve. Sidoqoftë, pavarësisht faktit se nuk hapet rasti në QPS, duhet të bëhet një shënim dhe të verifikohet fletëparaqitja në regjistrin përkatës.

b) Hapja e rastit në QPS

Nëse punëtori profesional përcakton se kriteret profesionale dhe ligjore për ekzistimin e keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijës janë përmbushur, atëherë hapet rasti në QPS. Është i nevojshëm të caktohet një **punëtor profesional përgjegjës** në QPS, i cili ka për detyrë ta koordinojë procesin e mëtutjeshëm të mbrojtjes së fëmijës.

c) Ndërmarrja e ndërhyrjes urgjente

Nëse punëtori profesional përcakton që situata është alarmante, ndërhyrjet urgjente për mbrojtjen e fëmijës duhet të ndërmerren në fazën e parë të vlerësimit, të cilat zhvillohen pas një shqyrtimi urgjent të rastit, dhe shkëmbimit të informatave me policinë, prokurorinë dhe ndoshta institucionet shëndetësore ose institucionet e tjera. Është e domosdoshme të përforcohet bashkëpunimi i përbashkët i rastit ndërmjet policisë dhe Qendrës për Punë Sociale në momentin kur vërehet vepër penale potenciale (ose ekziston rrezik nga) vepra penale ndaj fëmijës, për shkak të harmonizimit të procedurave të mëtejshme dhe grumbullimit të provave.

Hapi 2: Vlerësimi i detajuar

Pas vlerësimit të triazhës, në të cilën emërohet **punëtori profesional përgjegjës** dhe ekipi profesional, vlerësimi i detajuar është faza e radhës e vlerësimit e cila ka për qëllim të përcaktojë:

- Sa është shkalla e rrezikut për fëmijën?
- Cilat rreziqe për fëmijën mund të përcaktohen gjatë kësaj faze të procedurës?
- A ekziston rrezik i cili e kërcënon shëndetin dhe formimin e fëmijës?
- Cilat masa të ndihmës dhe mbrojtjes mund t'i japen fëmijës dhe familjes, respektivisht prindit jo të dhunshëm?

Vlerësimi i rrezikimit të fëmijës përcaktohet në të gjitha situatat në të cilat mund të rrezikohet jeta dhe shëndeti i fëmijës, pavarësisht nëse bëhet fjalë për KNF-në, dhunën në familje, pozitën e pafavorshme shëndetësore, sociale ose materiale të familjes, ose disa rrethana tjera që e pengojnë fëmijën ta arrijë nivelin e duhur të shëndetit dhe formimit. Ajo duhet të zgjasë rreth një javë, që është kohë e mjaftueshme për të përcaktuar gjendjen dhe nevojat e fëmijës dhe familjes, në mënyrë që të sigurohen masat përkatëse të ndihmës dhe mbrojtjes.

Nëpër këtë vlerësim duhet të përfshihen këto faza në përcaktimin e gjendjes dhe rrezikut:

- Observimi dhe intervista me fëmijën (në pajtim me moshën e fëmijës, gjendjen psikologjike të fëmijës, sjelljen). **Punëtori profesional** duhet të shtrojë pyetje rutinore në lidhje me keqpërdorimin / neglizhimin, dhunën në familje, intervistimin vetëm të fëmijës dhe / ose prindin joabuzues;
- Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave nga personat profesionalë nga shërbimet e tjera me të cilët ka rënë në kontakt (institucionet shëndetësore, arsimore, sociale, OJQ-të);
- Vlerësimi i dëmtimeve të fëmijës dhe vlerësimi i mëtutjeshëm i rrezikut të fëmijës së ekspozuar - përcaktimi i shkallës së rrezikut - **shkalla e ulët e rrezikut, shkalla e mesme e rrezikut dhe shkalla e lartë e rrezikut**;
- Përcaktimi i masave dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës në familje;
- Njoftimi i rezultateve të vlerësimit fillestar;
- Procedurat e tjera specifike për shërbimet;

Hapi 3: Vlerësimi gjithëpërfshirës - takimi konsultativ me sektorët e tjerë

Nëse me vlerësimin fillestar përcaktohet se fëmija është keqpërdorur ose lënë pas dore në familjen ose ka rrezik të ndodhë, **punëtori profesional përgjegjës** duhet të caktojë **tatim konsultativ** me sektorët e tjerë (QPS-në, policinë, shërbimet shëndetësore, institucionet arsimore, etj.). Qëllimi i takimit konsultativ është kryesisht shkëmbimi i informatave, rregullimi i hapave dhe veprimi i sinkronizuar i shërbimeve të ndryshme për t'iu shmangur ritraumatizimit të fëmijës dhe për të shpejtuar procesin e mbrojtjes së fëmijës.

Cilat gjendja kërkojnë takim konsultativ me sektorët dhe shërbimet e tjera?

- Të gjitha paraqitjet e abuzimit seksual dhe keqpërdorimit të rëndë fizik kërkojnë takim të tillë në fazat e hershme të vlerësimit, madje edhe në fazën fillestare të vlerësimit;
- Mundësimi i sigurisë së fëmijës për çka nevojitet bashkëpunimi dhe marrëveshja nga ana e shërbimeve të shumta;
- Grumbullimi i provave për procedurën gjyqësore nga sektorët e ndryshëm, por në të njëjtën kohë duhet të mbrohet fëmija nga ritraumatizimi përmes marrjes në pyetje dhe kontrolleve të shumta;
- Në rastet kur kërkohet vlerësimi i specializuar që nënkupton vlerësim forenzik (vlerësimi gjyqësor mjekësor dhe vlerësimi gjyqësor psikiatrik) për planifikimin dhe harmonizimin e tij;

Përkufizimet për keqpërdorimin dhe shpërfilljen

Përkufizimi i përgjithshëm i keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve

Në përgjithësi, keqpërdorimi dhe neglizhimi i fëmijëve përkufizohet si "çdo formë e keqpërdorimit fizik dhe / ose emocional, abuzimit seksual, neglizhimit ose trajtimit të pakujdesshëm ose eksploatimit komercial ose llojit tjetër të eksploatimit që potencialisht ose realisht paraqet kërcënim ose dëm për shëndetin e fëmijës, mbijetesën, formimin ose dinjitetin, në kontekstin e marrëdhënies së ndërsjellë së përgjegjësisë, besimit ose fuqisë" (1).

Në Raportin Botëror për Dhunën dhe Shëndetin dhe Raportin e OBSH-së për Konsultimin për Parandalimin e Keqpërdorimit të Fëmijëve në vitin 1999¹, janë identifikuar katër lloje të keqpërdorimit dhe neglizhimit të fëmijëve:

- keqpërdorimi fizik;
- abuzimi seksual;
- keqpërdorimi emocional ose psikologjik;
- neglizhimi.

Keqpërdorimi fizik

Keqpërdorimi fizik i fëmijëve përkufizohet si përdorim i qëllimshëm i forcës fizike kundër fëmijës që shkakton dëmtim ose ekziston mundësia ta dëmtojë shëndetin e fëmijës, mbijetesën, formimin ose dinjitetin. Kjo përfshin goditjen, rrahjen, shkelmimin, shkundjen, kafshimin, mbytjen, përvëlimin, djegien, helmimin dhe ngufatjen. Shumë shpesh, dhuna fizike ndaj fëmijëve në shtëpi, në të vërtetë bëhet me sendin për ta dënuar. Arsyeja më e zakonshme e keqpërdorimit fizik është ndëshkimi trupor si masë disiplinore në "edukimin" e fëmijës.

¹ Report of the consultation on child abuse prevention, 29-31 March 1999. Geneva, World Health Organization, 1999

Në keqpërdorimin fizik bie edhe shkaktimi i qëllimshëm i simptomave të sëmundjes të fëmija nga ana e prindërve, kujdestarëve ose të moshuarve të tjerë që janë përgjegjës për fëmijën (i ashtuquajti Minchausen sindrom by proxy, Sindromi Minhauzen nga i afërmi).

Abuzimi seksual

Abuzimi seksual përkufizohet si përfshirja e fëmijëve në aktivitetin seksual, të cilin fëmija nuk e kupton plotësisht dhe kuptohet, për të cilin nuk është në gjendje të japë pëlqimin e informuar, ose për të cilin fëmija ende nuk është i përgatitur nga aspekti zhvillimor, ose ndonjë lloj tjetër i veprimtarive me të cilat shkelen ligjet ose normat sociale të shoqërisë. Fëmijët mund të abuzohen seksualisht edhe nga të rriturit, por edhe nga fëmijët e tjerë, të cilët janë (të paktën 5 vjet më të vjetër) sipas moshës dhe fazës së tyre të formimit, ndodhen në pozitën në të cilën janë përgjegjës, e kanë besimin e viktimës ose kanë fuqi mbi të. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: nxitjen ose detyrimin e fëmijës të përfshihet në aktivitetin seksual të kundërligjshëm; shfrytëzimin e fëmijës për eksploatimin në prostitucion ose praktika të tjera të paligjshme seksuale; eksploatimin e fëmijëve për shfaqje dhe materiale pornografike“.

Në abuzimin seksual përfshihen: ekspozimi i shikimit dhe shfaqja e fotografive pornografike, pikturimi i trupit të fëmijës, prekja e trupit në mënyrë seksuale, nxitja e fëmijës të prek trupin e të rriturit në mënyrë seksuale, përpjekja për marrëdhënie seksuale dhe bërja e marrëdhënieve seksuale (anale, vaginale). Prandaj, abuzimi seksual mund të jetë pa kontakt trupor dhe mund të jetë me kontakt (jopenetrante dhe penetrante).

Keqpërdorimi emocional (psikologjik) dhe neglizhimi

Keqpërdorimi emocional ose psikologjik i përfshin rastet e izoluara në mënyrë të barabartë, si dhe dështimet e vazhdueshme të prindit / kujdestarit, me kalimin e kohës, për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për formimin dhe mbështetjen e fëmijës. Të gjitha veprimet që i përkasin kësaj kategorie mbajnë një gjasë të lartë të dëmtimit të shëndetit fizik ose mendor të fëmijës, ose formimit fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Keqpërdorimi i këtij lloji përfshin: mohimin, degradimin, akuzimin, kërcënimin, frikësimin, terrorizimin, izolimin, korruptimin, diskriminimin ose talljen; eksploatimin dhe format e tjera jofizike të refuzimit ose armiqësisë dhe mosdhënies së përgjigjeve emocionale.

Neglizhimi

Neglizhimi i përfshin rastet e izoluara në mënyrë të barabartë, si dhe dështimet e vazhdueshme të prindit / kujdestarit për të siguruar kushte për formimin dhe mirëqenien e duhur të fëmijës - kur prindi është në gjendje ta bëjë këtë - në njërin ose në më shumë nga fushat si vijon:

- mbrojtja shëndetësore;
- arsimi;
- zhvillimi emocional;
- të ushqyerit;
- strehimi dhe kushtet e sigurta për jetë.

Kjo e fundit nënkupton edhe dështimin për të mbikëqyrur dhe mbrojtur fëmijën nga çdo lloj dëmi, në masën e mundshme.

Neglizhimi duhet të dallohet nga varfëria, kur prindërit / kujdestarët, megjithë dëshirës më të mirë, nuk janë në gjendje t'i sigurojnë fëmijës atë që i duhet për ta formuar.

Eksplotimi

Eksplotimi komercial ose lloji tjetër i eksploatimit të fëmijës i referohet shfrytëzimit të punës së fëmijës ose aktiviteteve të tjera, në të mirë të të tjerëve. Ky lloj keqpërdorimi e përfshin punën e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve, rrëmbimin e fëmijëve ose trafikimin e fëmijëve me qëllim të eksploatimit të punës së fëmijëve ose eksploatimit seksual. Këto veprime e prishin shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve, formimin e tyre emocional, social dhe moral dhe procesin e tyre arsimor.

Faktet mbi keqpërdorimin dhe neglizhimin e fëmijëve

Pse keqpërdorimi dhe neglizhimi i fëmijëve është një problem shëndetësor publik dhe social?

Për shkak se ato janë shkaqe të vdekjes për fëmijët, shkaqe të dëmtimit të shëndetit të tyre fizik dhe mendor, shkaqe të pasojave afatgjata që e prishin formimin e fëmijëve. Fëmijët e keqpërdorur shpesh vuajnë nga lëndimet fizike, të tilla si: prerjet, mpiksjet e gjakut, djegiet, frakturat. Keqpërdorimi dhe neglizhimi shkaktojnë stres që e prish formimin e hershëm të trurit. Stresi ekstrem mund të prishë sistemin nervor dhe imunitar². Fëmijët të cilët u keqpërdorën ose u lënë pas dore në fëmijëri, më vonë si të rritur kanë rrezik më të madh për të zhvilluar probleme shëndetësore³. Këto probleme e përfshijnë alkoolizmin, depresionin, përdorimin e drogës, sjelljet e rrezikshme seksuale, vetëvrasjet, çrregullimet e të ngrënit dhe disa sëmundje kronike⁴.

Cilët fëmijë janë në rrezik të keqpërdorimit dhe neglizhimit

Të gjithë fëmijët janë të ekspozuar ndaj keqpërdorimit dhe neglizhimit. Por, disa faktorë mund ta rrisin rrezikun e keqpërdorimit dhe neglizhimit, megjithëse prania e tyre nuk do të thotë gjithmonë se do të ndodh ajo. Sipas modelit ekologjik të faktorëve të rrezikut për dhunën, ato ndahen në grupet si vijon: faktorët individualë, faktorët familjarë, faktorët e komunitetit dhe faktorët shoqërorë të rrezikut.

² Perry B. Examining child maltreatment through a neurodevelopmental lens: clinical applications of the neurosequential model of therapeutics. *Trauma and loss*, 2009, 4(4): 240–255.

³ Felitti VJ, Anda RF, Nordenberg D, Williamson DF, Spitz AM, Edwards V, Koss MP, Marks JS. Relationship of childhood abuse and household dysfunction to many of the leading causes of death in adults: The Adverse Childhood Experiences (ACE) Study. *American Journal of Preventive Medicine*, 1998, 14:245–258.

⁴ Ranyan D, Wattam C, Ikeda R, Hassan F, Ramiro L. Child abuse and neglect by parents and caregivers. In: Krug E, Dahlberg LL, Mercy JA, Zwi AB, Lozano R, editors. *World Report on Violence and Health*. Geneva, Switzerland: World Health organization; 2002. p.59-86.

Faktorët individualë të rrezikut të fëmijëve janë: mosha (fëmijët deri në 4 vjeç janë në rrezik më të lartë të vdekjes dhe dëmtimit serioz si rezultat i keqpërdorimit dhe neglizhimit), paaftësia (fizike dhe intelektuale), temperament i rëndë i fëmijës, hiperaktiviteti. Faktorët familjarë të rrezikut janë marrëdhëniet e konfliktit në martesë, niveli i lartë i stresit në familje, dhuna në familje, keqpërdorimi i alkoolit dhe drogës nga anëtarët e familjes, izolimi i familjes dhe mungesa e mbështetjes sociale, problemet kronike shëndetësore të anëtarëve të familjes. Faktorët e rrezikut në nivelin e komunitetit dhe në nivelin e shoqërisë janë: varfëria, papunësia, niveli i lartë i dhunës në komunitet, pabarazitë e llojeve të ndryshme që krijojnë një mjedis që e toleron keqpërdorimin dhe neglizhimin e fëmijëve.

Korniza për vlerësimin e rrezikut për keqpërdorimin dhe neglizhimin e fëmijëve dhe familjeve të tyre

Kur bëhet vlerësimi nëse fëmija ka rrezik më të madh për KNF, faktorët e mëposhtëm duhet të merren parasysh⁵:

FORMIMI I FËMIJËVE

Shëndeti

- Faktorët e vetë çrregullimit;
- Mbrojtja e duhur shëndetësore;
- Rritja adekuate, formimi, mirëqenia fizike dhe mendore;
- Faktorët gjenetikë;
- Imunizimi i rregullt dhe kontrollet e rregullta sistematike;
- Mbrojtja dentare;
- Këshilla mbi seksualitetin dhe abuzimin me substancat e përshtatshme për moshën;

Arsimi

- Mundësitë për të luajtur dhe bashkëveprimi në grup me fëmijët;
- Qasje të siguruar te librat;
- Të mundësojë përshtatjen e aftësive dhe interesave;
- Shprehja e interesit të prindërve për aktivitetet arsimore, progresin dhe arritjet e fëmijës;
- Masat e ndërmarra për t'i zbuluar nevojat e veçanta të fëmija;

Formimi emocional dhe bihejvioral

- Përgjigjja adekuate e fëmijës ndaj prindërve / kujdestarëve;
- Natyra dhe cilësia e lidhjes së hershme të fëmijës, karakteristikat dhe temperament i fëmijës;

⁵ Është marrë dhe përshtatur nga „Devon partnership NHS, Child protection Protocol, Policy Number C 26, reviewed March 2008“.

- Përshtatja për të ndryshuar, reagimi ndaj stresit dhe vetëkontrolli i duhur;

Identiteti

- Perceptimi i fëmijës për veten dhe aftësitë e veta;
- Ndjenja e vetërespektit dhe fotografia adekuate për veten;
- Ndjenja e pranimit nga familja, bashkëmoshatarët dhe komuniteti i gjerë;

Familja dhe marrëdhëniet sociale

- Aftësia e fëmijës për të empatuar dhe kuptuar të tjerët;
- Marrëdhëniet e qëndrueshme dhe të ngrohta me prindërit / edukatorët / kujdestarët;
- Marrëdhëniet me vëllezërit dhe motrat dhe bashkëmoshatarët sipas moshës;
- Përgjigjja adekuate nga familja për këto marrëdhënie;

Paraqitja sociale

- Qëndrimi i fëmijës ndaj pamjes dhe sjelljes së vet;
- Përshtatshmëria e mënyrës së veshjes sipas moshës, gjinisë, kulturës dhe përkatësisë fetare;
- Mirëmbajtja e higjienës;
- Këshillat e prindërve / kujdestarëve për pamjen;

Kujdesi mbi veten

- Përvetësimi i aftësive praktike, emocionale dhe komunikuese;
- Shkathtësitë e veshjes dhe të vetëushqyerit;
- Vetëbesimi dhe aftësitë praktike që mundësojnë zhvillimin e pavarësisë;
- Inkurajimi i përvetësimit të aftësive për zgjidhjen e problemeve;
- Ndikimi i çrregullimeve të fëmijët dhe grupet e tjera;
- Rrethanat sociale që kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive të vetëkujdesit;

KAPACITETET E PRINDËRVE

Kujdesi themelor

- Sigurimi i kujdesit fizik, mjekësor, dentar për fëmijën;
- Sigurimi i ushqimit, strehimit, veshje të pastër dhe të përshtatshme;
- Higjiena e përshtatshme personale;

Të mundësuarit e sigurisë

- Mbrojtja nga rreziku dhe dëmtimi;
- Mbrojtja nga të rriturit e pasigurt dhe fëmijët e tjerë;
- Mbrojtja nga vetëdëmtimi;
- Njohja e situatave të rrezikshme;

Ngrohtësia emocionale

- Ndjenja pozitive të fëmija se është vlerësuar dhe e ka identitetin personal;
- Marrëdhënia e besueshme, e qëndrueshme dhe e ngrohtë me të rriturit;
- Të rriturit që ofrojnë një përgjigje të ndjeshme përkatëse;
- Demonstrimi i ngrohtësisë, lavdërimit dhe inkurajimit;

Stimulimi

- Inkurajimi dhe stimulimi kognitiv;
- Përgjigja adekuate për pyetjet e fëmijës sipas nivelit të zhvillimit të gjuhës;
- Inkurajimi i lojës dhe mundësimi i arritjeve arsimore;
- Inkurajimi i suksesit dhe mundësimi i pranisë në shkollë;

Udhëheqja dhe kufijtë

- Demonstrimi dhe modelimi i sjelljes së duhur ndaj fëmijës;
- Kontrollimi i emocioneve dhe bashkëveprimit me të tjerët;
- Inkurajimi i zhvillimit të modelit të brendshëm të vlerave morale dhe ndërgjegjësimit;
- Zhvillimi i sjelljes së duhur sociale;
- Mundësimi i aktiviteteve kërkimore, të mësuarit dhe marrëdhënia jo mbrojtëse;
- Kufijtë që përfshijnë zgjidhjen sociale të problemeve, kontrollimi i hidhërimit dhe zemërimit, disiplina efikase dhe formimi i sjelljes;

Stabiliteti

- Sigurimi i ambientit të qëndrueshëm familjar që mundëson zhvillimin e lidhjes së sigurt dhe zhvillimin optimal;
- Përshtatja e prindit me formimin e fëmijës;
- Mbajtja e kontakteve të fëmijës me të rriturit e rëndësishëm;

FAKTORËT FAMILJARË DHE AMBIENTI

Historia familjare dhe funksionimi

- Faktorët biologjikë dhe psikosocialë;
- Kush jeton në familje dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijën;
- Ndryshimet e rëndësishme në përbërjen e familjes;
- Përvoja e fëmijës me prindërit;
- Ngjarjet e rëndësishme jetësore dhe rëndësia e tyre për familjen;
- Funksionimi i familjes, marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve dhe motrave dhe ndikimi mbi fëmijën e veçantë;

Anët e fuqishme dhe të dobëta të prindërve

- Marrëdhëniet midis prindërve të ndarë / të divorcuar;
- Sistemi më i gjerë i familjes: kush është ai dhe cilat janë rolet dhe rëndësia e tyre për familjen;

- Personalitetet e tjera të rëndësishme për familjen jashtë rrethit të të afërmeve: kush i përbën ata dhe cilat janë rolet dhe rëndësia e tyre për familjen;

Banimi

- Ekzistimi i nevojave themelore si uji, ngrohja, tualeti, kuzhina;
- Organizimi i banjës, higjenës dhe sigurisë së shtëpisë;
- A janë të përshtatshëm për moshën e fëmijës edhe anëtarët e tjerë të familjes;
- A ka ndonjë anëtar me aftësi të kufizuara në familje;

Punësimi

- Kush punon në familje dhe marrëdhënia me të tjerët;
- Pamjet e familjes për punën dhe statusin e punës;
- Ndikimi mbi fëmijën;

Të ardhurat

- Të ardhurat e përballueshme, të qëndrueshme;
- Shfrytëzuesit e ndonjë ndihme;
- Nëse të ardhurat i përmbushin nevojat e familjes;
- Shfrytëzimi i duhur i burimeve;
- Vështirësitë financiare që prekin fëmijën;

Integrimi familjar

- Komuniteti në të cilin jeton familja dhe ndikimi i tij mbi fëmijën dhe familjen;
- Shkalla e izolimit ose integritit me grupet e moshatarëve, miqve, marrëdhëniesve shoqërore dhe kuptimi i tyre;
- Burimet e komunitetit;
- Shërbimet dhe mundësitë e disponueshme nga komuniteti;
- Sigurimi i mbrojtjes shëndetësore parësore, kujdesit ditor, shkollës, transportit, dyqaneve dhe aktiviteteve argëtuese;
- Qasja në burimet dhe ndikimi mbi familjen dhe të gjithë anëtarët e saj;

2. Propozim-plani aksional për zvogëlimin e dhunës

TEMA I - DHUNA

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

TEMA II - SIGURIA NË SHKOLLË DHE BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

TEMA III - BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

TEMA IV – MBAJTJA DHE PLOTËSIMI I KRITEREVE DHE PRAKTIKAVE TË VENDOSURA

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

TEMA V – PJESEMARRJA DEMOKRATIKE E NXENËSVE NË SHKOLLË

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

TEMA VI – DHUNA NË MARRËDHËNIEN MËSIMDHËNËS – NXENËS

- Politikat dhe procedurat
- Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve
- Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënës

Propozim-plani aksional për zvogëlimin e dhunës

Në bazë të bisedave të bëra me grupe nxënësish, prindër dhe mësime dhënë, janë propozuar tri tema që është e domosdoshme të adresohen gjatë vitit të ardhshëm kalendarik: dhuna në mesin e moshatarëve, siguria në shkollë dhe bashkëpunimi me institucionet në drejtim të detektimit dhe parandalimit të dhunës.

TEMA I – DHUNA				
AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHYRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësime dhënëve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësime dhënësit, prindërit dhe nxënësit	
I.1. Protokollin për përgjigjen ndaj situatave të dhunës së moshatarëve (bulin)	Hartimi i protokollit për t'u përgjigjur situatave të dhunës së moshatarëve që do t'i përkufizojë procedurat në lidhje me raportimin, trajtimin e viktimës, dëshmitarët dhe personin / grupin që kryejnë dhunë, dhe masat për ndjekjen e mëtejshme dhe sanksionimin e dhunës	Paraqitja e protokollit për të gjithë faktorët në shkollë (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës)	Theksimi i protokollit në vendet publike të shkollës, të vepruarit sipas protokollit	
PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, përfaqësuesit e shërbimit profesional, mësime dhënësi i lëndës dhe mësime dhënësi i mësimin klasor (koordinatorët e aktiviteteve për zvogëlimin e dhunës në shkollë),	Kujdestarët e klasës dhe shërbimi profesional	Shërbimi profesional Të gjithë në shkollë	

	prindi i nxënësit të lëndës dhe prindi i nxënësit të mësimit klasor			
II. Parandalimi i dhunës	Përfshirja e trajnimeve dhe pjesëmarrja në projektet mbi njohjen dhe përgjigjen ndaj situatave të dhunës së moshatarëve në programin vjetor të shkollës	1. zbatimi i trajnimeve (interne – sipas programit për ASHJ-në dhe të tjera eksterne – me ekspertët e jashtëm) për sensibilizimin e: - dhunës - të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve - komunikimit jo të dhunshëm 2. përfshirja në projektet për - ndërmjetësimin e moshatarëve - zgjidhjen e konflikteve, me theks të veçantë të dhunës - inkluzionin e personave me aftësi të kufizuara me mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit 3. përforcimi i rezistencës së nxënësve 4. përfshirja e shërbimit profesional në trajnimet për të ofruar shërbime këshillëdhënëse për nxënësit që janë iniciatorë të dhunës	Zbatimi i programit gjysmëvjetor / vjetor të parandalimit të dhunës brenda aktiviteteve në klasë dhe aktiviteteve jashtë mësimi	

PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional	Koordinatorët e programit për zvogëlimin e dhunës	Kujdestarët e klasës, shërbimi profesional	
--------------------------------	--------------------------------	--	---	--

TEMA II – SIGURIA NË SHKOLLË DHE BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT

AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHYRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit	
II. 1 Mjedisi i sigurt i shkollës (mjedisi fizik)	Parashikimi i vlerësimeve periodike të sigurisë në objektin shkollor Miratimi i vendimit / rregullores për vendosjen e procedurave për paraqitjen dhe miratimin e hyrjes në shkollë gjatë orëve të mësimi dhe pushimeve Miratimi i vendimit / rregullores për vendosjen e procedurave për kujdestari nga mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë orëve të mësimi dhe pushimeve Miratimi i masave të veçanta të sigurisë për nxënësit vulnerabilë (me	Përpilimi i anketës së vlerësimit periodik të sigurisë në objektin shkollor përmes anketave për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit Prezantimi i rregulloreve dhe masave të veçanta të sigurisë për të gjithë faktorët në shkollë (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës)	Zbatimi i vlerësimit periodik të sigurisë në objektin shkollor përmes anketave të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve dhe prezantimit publik të rezultateve të fituara Zbatimi konsekuent i procedurës për paraqitjen dhe miratimin e hyrjes në shkollë gjatë orëve të mësimi dhe pushimeve Zbatimi konsekuent i procedurës për kujdestari nga mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë orëve të mësimi dhe pushimeve Zbatimi konsekuent i masave të veçanta të sigurisë për nxënësit	

	aftësi të kufizuara, vajza, grupe pakicash)		vulnerabilë (me aftësi të kufizuara, vajza, grupe pakicash)	
II.2 Mjedisi i sigurt i shkollës (mjedisi social)	Përfshirja e angazhimit për ndërtimin e atmosferës së respektit për diversitetin, tolerancën dhe bashkëpunimin në programin vjetor të shkollës.	1. zbatimi i trajnimeve nga ekspertët e jashtëm për - ndërtimin e ekipit - besimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet mësimeve, mësimeve dhe nxënësve dhe ndërmjet mësimeve dhe prindërve 2. përfshirja e shërbimit profesional dhe koordinatorëve të aktiviteteve për zvogëlimin e dhunës në trajnimet për zbatimin e aktiviteteve për ndërtimin e ekipit, besimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet nxënësve	Zbatimi i programit gjysmëvjetor / vjetor me aktivitetet për respektimin e dallimeve, tolerancës, punës ekipore dhe bashkëpunimit Ndërtimi i klimës shkollore të kooperativitetit përkundrejt kompetitivitetit, respektimit të dallimeve dhe tolerancës, nxitjes së të menduarit kritik në punën e përditshme me nxënësit gjatë kohës së mësimi dhe aktiviteteve jashtë mësimi Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta periodike të nxënësve, mësimeve dhe prindërve për ta avancuar sigurinë në shkollë	

	Zhvillimi i politikave dhe procedurave për ndëshkim të drejtë duke e respektuar dinjitetin e personalitetit.	Të njoftuarit e të gjithë të përfshirëve në shkollë me politikat dhe procedurat e ndëshkimit të drejtë duke e respektuar dinjitetin e personalitetit	Zbatimi konsekuent i politikave dhe procedurave për ndëshkim të drejtë duke e respektuar dinjitetin e personalitetit	
PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional, mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	Kujdestarët e klasës dhe shërbimi profesional	Shërbimi profesional Të gjithë në shkollë	

TEMA III - BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET

AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHYRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënësit	
III.1. Bashkëpunimi me institucionet në komuna	Vendosja e planit për bashkëpunim me institucionet dhe organizatat në nivel lokal (Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Punë Sociale Gazi Babë, Stacioni Policor, Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë - Megjashi, Këshilltarët / Komisioni Komunal për Arsim, Konsultorja për Zhvillim, Psikoterapisti, Defektologu, etj.) në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të dhunës në shkollë, si dhe ndarjen e përgjegjësisë për ofrimin e ndihmës	Prezantimi i planit të gjithë faktorëve në shkollë Prezantimi i përgjegjësisë, detyrave dhe përvajave në drejtim të parandalimit dhe zvogëlimit të dhunës në shkollën e institucioneve dhe organizatave të ndryshme	Zbatimi konsekuent i planit Organizimi i ligjëratave, debateve dhe punësive brenda ose jashtë shkollës ku mësimeve, prindërit dhe nxënësit do të njoftohen me punën dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe organizatave të ndryshme Zbatimi i aksioneve të përbashkëta të kujdesit në komunitet	
III.2. Bashkëpunimi me shkollat në komunën dhe shtetin	Hartimi i planit për shkëmbimin e përvajave shkollore nga zbatimi i programit për parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës në shkollat		Formimi i rrjetit të bashkëpunimit për shkëmbimin e përvajave përmes platformave elektronike dhe kontaktit të drejtpërdrejtë	

PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional, mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	Mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës të gjithë në shkollë	
--------------------------------	--	---	---	--

TEMA IV – MBAJTJA DHE PLOTËSIMI I KRITEREVE DHE PRAKTIKAVE TË VENDOSURA

AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHYRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënësit	
I.1. Mbajtja e kriterëve dhe praktikave të vendosura	Dokumentimi me shkrim dhe përpunimi i hollësishëm i të gjitha kriterëve, procedurave, kodeve dhe rregullave shkollore	Paraqitja e protokollit për të gjithë faktorët në shkollë (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës)	Veprimi konsekuent sipas dokumenteve të shkruara	
PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, përfaqësuesit e shërbimit profesional, mësimeve të lëndës dhe mësimeve të mësimit klasor (koordinatorët e aktiviteteve për zvogëlimin e dhunës në shkollë), prindi i nxënësit të lëndës dhe prindi i nxënësit të mësimit klasor	Kujdestarët e klasës dhe shërbimi profesional	Shërbimi profesional Të gjithë në shkollë	
II. Plotësimi i kriterëve dhe praktikave të vendosura	Përfshirja e trajnimeve dhe pjesëmarrja në projektet me tema me interes për nxënësit dhe mësimeve në programin vjetor të shkollës	1. zbatimi i trajnimeve me ekspertët e jashtëm për sensibilizimin për: - dhunën seksuale - kohezionin social - të drejtat e fëmijëve	Zbatimi i programit gjysmëvjetor / vjetor për parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës dhe diskriminimit	

		- fëmijët nën rrezik - punën ekipore 2. përforsimi i rezistencës së nxënësve		
PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional	Koordinatorët e programit për zvogëlimin e dhunës	Kujdestarët e klasës, shërbimi profesional	

TEMA V – PJESËMARRJA DEMOKRATIKE E NXËNËSVE NË SHKOLLË

AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHJRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit	
II.1 Zgjedhjet	Parashikimi / plotësimi dhe revizioni i procedurës për zgjedhjen e kryesisë së klasës dhe komunitetit të shkollës ⁶	Të njoftuarit me procedurën e zgjedhjes së kryesisë së klasës dhe komunitetit të shkollës	Zbatimi i zgjedhjeve të drejta dhe demokratike të kryesisë së klasave në shkollë dhe komunitetit të shkollës	
II.2 Aktivitetet për ndryshim	Përfshirja e planit të detajuar të punës në komunitetin e shkollës në Programin Vjetor të Shkollës	Koordinimi i aktiviteteve të nxënësve - anëtarëve të komunitetit të shkollës	Zbatimi i aktiviteteve për ndryshimin në shkollë nga komuniteti i shkollës	
III.3 Përfshirja në procesin e miratimit të vendimeve	Hartimi i procedurave për përfshirjen e përfaqësuesve të nxënësve në proceset e miratimit të vendimeve në shkollë	Trajnimi për nevojën dhe rëndësinë e përfshirjes demokratike të nxënësve në proceset e miratimit të vendimeve në shkollë	Përfshirja e nxënësve në proceset e miratimit të vendimeve në shkollë	

⁶Sipas Doracakut për Pjesëmarrjen Demokratike të nxënësve në shkollë
<http://pmio.mk/wp-content/uploads/2013/08/Demokratska-participacija-A.pdf>
<http://pmio.mk/wp-content/uploads/2013/08/Demokratska-participacija-M.pdf>

PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional, mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	Kujdestarët e klasës përgjegjës, mësimdhënësit - koordinatorët e aktiviteteve për zvogëlimin e dhunës	Kujdestarët e klasës, nxënësit, drejtori	
--------------------------------	--	---	---	--


TEMA VI – DHUNA NË MARRËDHËNIEN MËSIMDHËNËS – NXËNËS

AKTIVITETET	FUSHAT E NDËRHYRJES			KORNIZA KOHORE
	A. Politikat dhe procedurat	B. Kapacitetet dhe kompetencat e mësimeve, prindërve dhe nxënësve	C. Realizimi i aktiviteteve nga mësimeve, prindërit dhe nxënësit	
III.1. Funksionimi i politikave dhe procedurave ligjore në lidhje me sanksionimin e nxënësve dhe zero tolerancën për ndëshkrimin fizik dhe psikik të nxënësve	Përfshirja e angazhimit për zero tolerancë për ndëshkrimin fizik dhe psikik të nxënësve në dokumentet zyrtare të shkollës Hartimi i procedurës së sigurt për paraqitjen e ndëshkimit fizik dhe psikik nga mësimeve	Paraqitja e dispozitave të Ligjit për arsim fillor për përgjegjësinë e punonjësit (mësimeve) në rast të përdorimit të ndëshkimit fizik ose psikik mbi nxënësin të të gjithë faktorëve (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës) Prezantimi i Protokollit për sigurinë dhe trajtimin e nxënësve në rastet e dhunës, si dhe Strategjia për zvogëlimin e dhunës në shkollë 2012-2015 (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës) Prezantimi i procedurës për paraqitjen e ndëshkimit fizik dhe psikik (prezantimi me gojë, diskutimi dhe dorëzimi i kopjes në versionin e letrës)	Zbatimi konsequent i procedurave Krijimi i kushteve (kutia e porosive, paraqitja anonime, bashkëpunimi me OJQ-të lokale dhe të tjera) për zbatimin e procedurës për paraqitjen e ndëshkimit fizik dhe psikik	

		1. zbatimi i trajnimeve për alternativat e ndëshkimit dhe sigurimi i disiplinës nga ekspertët e jashtëm për mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit - komunikimi jo i dhunshëm - dhuna dhe pasojat - shkathtësitë e komunikimit - dhënia e mbështetjes - respektimi i procedurave (përgjegjësia individuale) - të kuptuarit dhe zgjidhja e konflikteve - menaxhimi me stresin		
PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional	Koordinatorët e programit për zvogëlimin e dhunës	Drejtori, shërbimi profesional, mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës	
III.2. Bashkëpunimi me shkollat në komunën dhe shtetin	Hartimi i planit për shkëmbimin e përvojave shkollore nga zbatimi i programit për parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës në shkolla	Inkurajimi i të mësuarit të ndërsjellë përmes ndarjes së praktikave pozitive të sigurisë në shkollë	Formimi i rrjetit të bashkëpunimit për shkëmbimin e përvojave përmes platformave elektronike dhe kontaktit të drejtpërdrejtë	

PERSONAT PËRGJEGJËS	Drejtori, shërbimi profesional, mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	Mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës, nxënësit - përfaqësuesit e komunitetit të shkollës	Mësimdhënësit përgjegjës - koordinatorët e aktiviteteve të zvogëlimit të dhunës të gjithë në shkollë	
--------------------------------	--	---	---	--

3. Plan për reagim në gjendje të jashtëzakonshme



Rreziku i drejtpërdrejtë	Personi përgjegjës për reagim në gjendje të jashtëzakonshme do të :	Reagimi i njëpasnjëshëm
•1. Ta aktivizojë ekipin për gjendje të jashtëzakonshme; •2. Identifikimi i rrezikut dhe ndikimi i prituri; •3. Shqyrtimi i planit për ragim; •4. Konsultohet me palët e interesuar në menaxhimin me gjendje të jashtëzakonshme (lokale, rajonale dhe kombëtare); •5. Vendosija për strategjinë; •6. Realizimi i strategjisë; •7. Fillimi me planin për komunikim; •8. Shqyrtimi për vazhdimin me punë	•1. E vlerëson sigurinë e të punësuarve dhe nxënësve •2. Kontakton shërbime për gjendjet e jashtëzakonshme nëse është e nevojshme; •3. Realizimi i evakuimit ose mbyllja e përkohshme nëse është e nevojshme; •4. Njoftimi i shërbimeve lokale për raste urgjente; •5. Ndjekja e ngjarjes dhe reagimi; •6. Aplikimi i Strategjisë së komunikimit.	•1. Vlerësimi i sigurisë së të punësuarve dhe nxënësve; •2. Vlerësimi i gjendjes së hapësirave në shkollë •3. Nëse ekziston dëm i dukshëm ose rrezik potencial, atëherë organizon shqyrtim të lokacioneve; •4. Nëse është e nevojshme, shqyrtohet mundësia për mbyllje të përkohshme; •5. Vazhdohet me punë nëse atë e lejojnë kushtet

Ekipi i organizimit për reagim në raste urgjente:

Roli	Personi përgjegjës	Kontakti:
Personi përgjegjës për reagim për gjendje urgjente		
Nëpunësi operativ		
		
Nëpunësi logjistik		
		
Nëpunësi i komunikimit		
Nëpunësi financiar		
Nëpunësi për siguri dhe mirëqenie		

Lista e personit kontaktues është përfshirë në Planin për menaxhim me gjendjet e jashtëzakonshme. I cili subjektet kontraktuese organizative dhe rajonale dhe mekanizmat për ndihmë pra, gjatë ose pas ngjarjes.

Harta e selisë së shkollës

Plani i evakuimit

Prioritet	Siguria e nxënësve dhe të punësuarve
Paraqitja e gjendjes së jashtëzakonshme	Në rast të gjendjes urgjente lajmërohu menjëherë
Evakuimi	Sinjal Informoni të punësuarit dhe nxënësit për evakuim urgjent gojarisht ose me telefon.
	Procedura Ndjekja e planit për evakuim
	Udhëzim i veçantë Mos e përdor ashensorin për dalje
Evakuim	Zona e evakuimit Rruga
	Procedura e evakuimit • Përgatitje për evakuim • Përgatitje në vendin e punës për braktisje të hapësirës • Fikje të kompjuterëve; shkyçje të gazsjellësit, si dhe të rrymës vetëm nëse është e sigurt të veprohet në atë mënyrë. • Në rast të zjarrit, mbyllni të gjitha dyert në hapësirën pas daljes nga ato - mos i mbyllni me çelës. • Ndihmoju njerëzve të cilët gjenden në rrezik. • Braktisja e ndërtesës përmes rrugës më të sigurt. • Përmblidhje të gjitha udhëzimeve nga personi përgjegjës për reagim në raste urgjente. • Të largohemi qetësisht nga vendi i mbledhjes ose të shkojmë në zone tjetër të sigurt si dhe të qëndrojmë atje derisa nuk marrim udhëzim për veprim tjetër. • Ndjekja e udhëzimit të personit për raste urgjente

Evakuim	• Askush të mos kthehet në cilëndo hapësirë - derisa nuk merr leje nga personi përgjegjës për gjendje të jashtëzakonshme.
Principet përgjithshme	• Prioritet është siguria e fëmijëve • Të gjithë të punësuarit dhe nxënësit janë përjashtuar automatikisht • Asnjë person nuk duhet ta lëmë në pozitë rreziku • Provë për evakuim bëhet së paku njëherë në vjet. Gjithashtu, njëherë në vjet kontrollohet edhe aparati për shuarje të zjarrit. • Nëpunësi i sigurisë është përgjegjës për ndërprerje të rrymës elektrike, si dhe t'i kontaktojë shërbimet urgjente dhe të dërgojë ndihmë e cila do të realizojë distancë të sigurt.
Komunikimi	Nëse evakuimi zgjat një periudhë më të gjatë kohore, personi përgjegjës për reagim në gjendje urgjente aktivizon plan të komunikimit për t'i informuar të punësuarit dhe nxënësit për hapat e më tutjeshme.
Përgatitjet	• Harta për evakuime doemos duhet të paraqitet qartë në të gjitha hapësirat • Personave që ndihmojnë u është siguruar një pasqyrë e shkurtër e planit për evakuim

1. Aksion në gjendje të veçanta urgjente

Zjarr në ndërtesën	1. Thirreni shërbimin kundërzjarrit në 193 dhe ndiqni instruksionet, 2. Informoni të punësuarit dhe nxënësit për braktisjen e hapësirës, 3. Paraqitni menjëherë gjendjen urgjente 4. Shuani zjarrin (vetëm nëse është e sigurt), 5. Nëse është e nevojshme – ndiqni procedurat për evakuim të lokacionit: • Evakuoheni në hapësirën për mbledhje me mbyllje të të gjitha dyerve dhe dritareve pas jush,
---------------------------	---

	• Kontrolloni nëse janë të gjitha të punësuarit, nxënësit dhe vizitorët në numër, • Kontaktoni me prindërit nëse ka fëmijë gjatë zjarrit.
Kërcënim me bombë ose materie të rrezikshme	• Thirrni policinë në numrin 192 dhe provoni t'i ndiqni udhëzimet, • Paraqitni kërcënimet e personit përgjegjës për gjendjet e jashtëzakonshme • Mos prekni kurrfarë sendi të dyshimtë, • Nëse gjeni ndonjë objekt të dyshimtë ose identifikoni rrezik në hapësirë të caktuar atëherë mund të shqyrtohet evakuimi, • Sipas nevojës, nën rrethana sigurie, braktisni rajonin menjëherë nëse jeni në afërsi të sendit të kërcënimit • Sigurohuni se askush prej njerëzve nuk lëviz rreth objektit • Sigurohuni se njerëzit që janë evakuuar janë vendosur në vend të sigurt <i>Nëse kërcënohen me bombë/materie të rrezikshme përmes thirrjes telefonike:</i> • Mos e ndërpritni lidhjen, • Nëse ka mundësi, bëni listë të kërcënimeve derisa zgjat biseda telefonike, • Mbani lajmëruesin në linjë sa më gjatë që mund që të merren sa më shumë informata, • Lajmëroni policinë në numrin 192, nga telefoni tjetër, pa dijeninë e bashkëbiseduesit. <i>Nëse kërcënimi nga bomba/materia e rrezikshme pranohet përmes postës:</i> • Vendosni zarfin në qese të pastër ose në mëngë, • Shmangni prekjen e mëtutjeshme të zarfit ose sendit, • Lajmërohuni në polici në 192 kërkoni dhe ndiqni këshillat, • Informoni personin përgjegjës për gjendje urgjente. <i>Nëse kërcënimi nga bomba/materia e rrezikshme pranohet në formë elektronike ose përmes ueb faqes së organizatës:</i> • Mos i fshini mesazhet,

	• Lajmërohuni në 192 për raste urgjente dhe kërkoni dhe ndiqni këshillat, • Informojeni personin përgjegjës për reagim në gjendje urgjente.
Fatkeqësi natyrore	<i>Ngjarje e befasishme gjatë orarit të punës</i> • Lajmërohu në 192 ose 195 nëse nevojiten shërbime për gjendje urgjente dhe ndiqni këshillat, • Këshillohuni me personin përgjegjës për reagim në gjendje urgjente, • Para fatkeqësisë ruani ose siguroni sendet që gjenden jashtë, siç janë mobilie e kopshtit ose shporta për mbeturina, • Fikeni pajisjen elektrike – mbulojeni/ose zhvendosni këtë pajisje më larg dritare, • Siguroni dritare (mbyllni perdet dhe grilat) dhe dyert e jashtme. Nëse është e nevojshme, ngjitni shirita në dritaret dhe dyert e xhamit. Përdorni thasë me rërë nëse është e nevojshme; • Mbyllni me çelës. <i>Gjatë motit të ligë:</i> • Qëndroni në ndërtesën dhe mos qëndroni në afërsi të dritareve, • Kufizoni paraqitjet në telefon, vetëm në raste urgjente përdorni telefonin, veçanërisht gjatë vetëtimës, • Paraqitni të gjitha çështjet në lidhje me sigurinë dhe mirëqenien e të punësuarve, nxënësve dhe vizitorëve të personit përgjegjës për reagim në gjendje urgjente, • Dëgjoni radion lokale ose televizorin me bateria, për paralajmërim të kohës dhe për këshilla. <i>Parashikimi për ngjarjet e ardhshme (p.sh. stuhi, vërshim)</i> • Nëse paralajmërimi për kohën dhe këshillat nga shërbimi për gjendje urgjente tregon ngjarje kohore serioze në lokacioni, personi përgjegjës për reagim në gjendje urgjente do të vendosë nëse organizata do të jetë e mbyllur përkohësisht. • Procedura për mbyllje e përkohshme doemos duhet të zbatohet.
Tërmeti	• Lajmërohuni në 193 ose 195 për gjendje urgjente dhe kërkoni dhe dërgoni këshillat,

	• Evakuohuni në vend të sigurt, • Kontrolloni nëse të gjithë të punësuarit dhe nxënësit janë në numër, • Prisni të gjitha këshillat e qarta nga shërbimi për gjendje urgjente ose këshillat e mëtutjeshme para se të vazhdoni me aktivitetet normale.
--	---

2. Ekipi lokal/rajonat për reagim

Niveli	Ekipi	Personi zyrtar përgjegjës	Nëpunës i emëruar
Lokal			

3. Detaje komunikimi

Detaje kontakti të organizimit

Funksioni	Emri dhe mbiemri	Email	Numri i telefonit:
Drejtor			
Menaxher i programit			
Menaxher i programit			
Koordinator i projektit			
Koordinator i shërbimit kulturor informativ për fëmijë - DX			
Menaxher i financave			
Koordinator/e për marrëdhënie me publikun			
Asistent softuerik			

Asistent softuerik			
--------------------	--	--	--

4. Numrat e telefonit për raste urgjente

Kopje të kësaj liste duhet të ketë në telefonin qendror

Shërbimi	Kontakti	Numri i telefonit
Policia	Rreziku i jetës ose urgjencë kritike kohore	192
	Incident që nuk e rrezikon jetën	192
	Stacion policor lokal	
Ambulanca	Shtëpitë shëndetësore lokale	
Policia	Shërbimi urgjent	193
Shërbimi shtetëror për raste urgjente		
Spitali	Shërbimi urgjent	194
Rryma	Elektroekonomia	
Livruesi i gazit		
Shërbimi për sigurinë e fëmijëve	Qendra për punë sociale	

Kontakti në bashkësinë lokale

	Kontakti	Numri i telefonit
		/

5. Kuadri i trajnuar

Anëtar i ekipit	Trajnim	I trajnuar nga

6. Informata të përgjithshme

Numri i telefonit			
Lokacioni		Numri i telefonit	
Institucioni	Lokacioni	Ofrues i shërbimit	Lokacioni për shkyçjen e shërbimit
Gaz			
Uji			
Rryma			